Të drejtat e Njeriut dhe personat interseks

ZHVILLIMET POZITIVE

» Ndryshime legjislative në disa vende Evropiane përnjohjen e personave interseks dhe luftimin e diskriminimit.

» Zhvillimi I jurisprudencës kombëtare që sfidon shkeljet e të drejtave të njeriut të personave interseks

» Zhvillimi I mënyrave të reja të ndërgjegjësimit nga OJQ-të LGBTI dhe interseks, organet e barazisë dhe strukturave të tjera kombëtare për të drejtat e njeriut.

» Zhvillimi I pikëpamjeve progresive tek disa praktikues të shëndetit mbi dëmin e shkaktuar nga ndërhyrjet e panevojshme mjekësore.

» Rritje e vëmendjes ndaj të drejtave të njeriut të personave interseks nga organizatat evropiane dhe ndërkombëtare

SHQETËSIME

» Trajtim i panevojshëm mjekësor dhe kirurgjik për të "normalizuar" seksin e foshnjave interseks pa pëlqim të plotë e të informuar

» Nuk respektohet e drejta e personave interseks për integritet fizik dhe aftësinë për të zhvilluar identitetin e tyre gjinor.

» Padukshmeri: ndërgjegjësimi i ulët publik për ekzistencën e personave interseks (disa prej të cilëve jane quajtur "hermafroditë" në të kaluarën) dhe problemet e tyre lidhur me te drejtat e njeriut.

» Vështirësi ne aksesimin e të dhënave mjekësore

» Interpretimi I shoqërisë si sistem binar mashkull-femër rezulton në stigmatizim dhe përjashtim social.

» Gjendja interseks ende klasifikohet si patologji.

» Ndërhyrje mjekësore në fetuset interseks.

» Mjekëzimi i njerëzve interseks pengon të drejtën e tyre për të arritur nivelin më të lartë të mundshëm shëndetësor.

» Procedurat e regjistrimit të lindjes dhe presioni mjekësor për t'u konformuar vendosin një barrë të madhe mbi prindërit e foshnjave interseks duke I shtyrë ata në marrjen e vendimeve të shpejta.

» Organet ndërkombëtare sportive zbatojnë procedura diskriminuese të verifikimit seksual.

REKOMANDIME

» Të ndalohen trajtimi mjekësore dhe ndërhyrjet kirurgjikale të panevojshme të personave interseks pa pëlqimin e tyre.

» Të respketohet e drejta e personave interseks për t'u mos u nënshtruar trajtimeve të caktimit të seksit.

» Të shqyrtohen klasifikimet mjekësore që patologjizojnë njerëzit interseks.

» Të përmirësohen ligjet dhe politikat në mënyrë që të lehtësohet njohja ligjore e personave interseks në dokumentat zyrtare, duke respektuar të drejtën e tyre për vetëvendosje.

» Të sigurohet që trajtimi i barabartë kombëtar dhe legjislacioni për krimet e urrejtjes të përfshijë edhe njerëzit e interseks.

» T'u jepet njerëzve interseks akses I plotë në të dhënat e tyre mjekësore

» Nevojitet hulumtim më i thellë për të adresuar në mënyrë të përshtatshme diskriminimin dhe shkeljet e tjera të të drejtave të njeriut të përsonave interseks.

» Të rritet ndërgjegjësimi i publikut dhe të përmirësohet trajnimi i profesionistëve për problemet që hasen nga njerëzit interseks.

» Të përfshihen njerëz interseks në zhvillimin e masave për adresimin e problemeve.

» Të përmirësohet këshillim i fëmijëve interseks dhe prindërve të tyre.

» Të lehtësohet qasja e njerëzve interseks ne drejtësi dhe te hetohen dhe njihen shkeljet e të drejtave të njeriut të kryera në të kaluarën.

Source: "Human Rights and Intersex People". Issue Paper published by the Council of Europe Commissioner for Human Rights (2015). © Council of Europe.
Translation published by Organisation Intersex International Europe e.V. (OII Europe) – www.oiieurope.org